



# PËRFAQËSIMI I GRAVE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE

---

Raport Monitorimi

Prill 2021

Ky botim u përgatit përmes projektit "Zgjedhje Gjithëpërfshirëse" të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet dhe përmbajtja e tij janë të autorit.



Autoret

Irena Shtraza

Ines Leskaj

@Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Tiranë, Prill 2021



## SHKURTIME

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
KZ	Kodi Zgjedhor
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor
LDG	Lidhja Demokratike e Gruas
LGI	Lëvizja e Gruas për Integrim
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
NISMA	Partia 'Nisma Thurje'
PD	Partia Demokratike
PD-AN	Koalicioni Zgjedhor "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim"
PS	Partia Socialiste
UN Women	Programi për Gratë i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

## TABELA E GRAFIKËVE

- Grafik 1.** Përqindja e burrave dhe grave kandidate në listat e partive
- Grafik 2.** Përqindja e burrave dhe grave kandidate në krye të listave shumë-emërore
- Grafik 3.** Përqindja e grave kandidate që kandidojnë rishtazi, si dhe për herë të parë në zgjedhjet parlamentare 2021
- Grafik 4.** Moshë mesatare e grave kandidate në listat shumë-emërore të PS, PD-AN, LSI dhe Nisma gjatë zgjedhjeve parlamentare 2021
- Grafik 5.** Përqindja e burrave dhe grave në përbërjen e KZAZ-ve në proceset zgjedhore të viteve 2013, 2017 dhe 2021
- Grafik 6.** Numri i burrave dhe grave të PD, PS, dhe LSI në 92 KZAZ-të e vendit
- Grafik 7.** Ndarja gjinore sipas emërimeve për PS dhe PD në 92 KZAZ-të e vendit
- Grafik 8.** Përfaqësimi i grave deputete në parlament 1991-2017.

## PËRMBAJTJA

SHKURTIME .....	3
TABELA E GRAFIKËVE .....	4
QËLLIMI I RAPORTIT .....	6
BARAZIA GJINORE NË LEGJISLACIONIN ZGJEDHOR.....	6
KUOTA GJINORE DHE SANKSIONET NGA KQZ.....	8
PËRFAQËSIMI I GRAVE NË LISTAT SHUMË-EMËRORE PARTIAKE .....	8
PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PËRBËRJEN E KZAZ.....	13
PËRFAQËSIMI GJINOR NË PARLAMENTIN SHQIPTAR.....	16
PËRFAQËSIMI I GRAVE NË ORGANET VENDIMMARRËSE PARTIAKE .....	17
QASJA GJINORE NË DOKUMENTET STATUTORË TË PARTIVE.....	20
PROBLEMATIKA KRYESORE E REKOMANDIME LIDHUR ME PËRFAQËSIMIN GJINOR .....	21
Referenca .....	23

## QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport monitorues do të analizojë përfaqësimin e grave në listat shumë-emërore të katër forcave politike në vend, Partisë Socialiste (PS), Koalicionit "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" (PD-AN), Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), si dhe forcës së re politike të regjistruar për herë të parë në zgjedhje parlamentare 'Nisma Thurje'.

Dokumente që u përdorën për hartimin e këtij raporti janë:

- Legjislacioni në fuqi me aktet nënligjore dhe administrative, përfshirë Kodi Zgjedhor dhe Ligjin mbi Partitë Politike;
- Statutet e partive;
- Të dhëna të publikuara apo të mbledhura nga forcat politike lidhur me anëtarët/et në strukturat partiake;
- Të dhëna të publikuara nga KQZ;
- Si dhe studime pararendëse mbi pjesëmarrjen e grave në politikëbërje.

## BARAZIA GJINORE NË LEGJISLACIONIN ZGJEDHOR

Përfaqësimi i barabartë gjinor në nivel politikëbërjeje në rang kombëtar është kusht për përmbushjen e të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe forcimit të parimit të mosdiskriminimit në shoqëri. Standardet demokratike për përfaqësim të barabartë gjinor edhe brenda partive politike duhet medoemos të reflektojnë detyrimin kushtetues kundër çfarëdo lloj forme diskriminimi gjinor, të shprehur qartë në legjislacionin zgjedhor, por edhe në atë të partive politike. Gjithsesi, barazia gjinore në politikëbërje e vendimmarrje vazhdon të mbetet një sfidë për sistemin politik shqiptar, ndërkohë që zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021 e gjejnë Shqipërinë në një moment delikat politik dhe ekonomik, duke marrë parasysh mungesën e ekuilibrave politikë në qeverisje qendrore dhe vendore, si dhe goditjet social-ekonomike që pësoi vendi pas tërmetit të 26 Nëntori 2019 dhe situatës lidhur me pandeminë prej COVID-19 që prej marsit 2020.

Koncepti i vendosur me ligj i "kuotës gjinore" në zgjedhjet parlamentare e lokale është i vonë në politikën shqiptare. Ai u aplikua për herë të parë në zgjedhjet 2009, pas ndërhyrjeve në Kodin Zgjedhor në vitin 2008, me anë të nenit 67, pika h. Aplikimi i këtij koncepti fillimisht lidhej vetëm me kuotën e kandidatimit prej 30%. Në amendimet në Kod u përcaktua detyrimi se "për çdo zone elektorale, të paktën 30% e listës shumë-emërore dhe 1 nga 3 emrat e listës shumë-emërore duhet t'i përkasin çdo gjinie". Në rast të shkeljes së kriterit të gjinisë në përbërjen e listave të kandidatëve për deputetë, KQZ vendosi sanksione administrative. Sanksionet e përcaktuara në këtë nen u vendosën për çdo zonë zgjedhore ku konstatoheshin shkelja. Përpos kësaj, në rastet e krijimit të vendeve bosh në Kuvend, KQZ

vendosi dhe sanksione plotësuese, duke plotësuar çdo vend bosh me kandidatin e radhës të gjinisë më pak të përfaqësuar, pavarësisht renditjes në listë.

Ndryshimet e fundit të bëra në Kodin Zgjedhor (2020) kanë bërë të mundur që të eliminohen sanksionet e buta me të cilat shpesh partitë politike i përballnin me dashje, për të anashkaluar pengesën gjinore duke vendosur burra në listat emërore. Këto ndryshime sjellin një bazë të re për përfaqësimin gjinor. Sipas Kodit Zgjedhor, mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit për respektimin e 30% të kuotës gjinore në listën shumë-emërore sjell refuzimin e regjistrimit të listës shumë-emërore në KQZ. Në këtë mënyrë, synimi për vendosjen e kuotës minimale gjinore 30% të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë merr një mbështetje të re dhe pritet të rezultojë më efektive sesa baza e mëparshme ligjore. Kodi Zgjedhor (2020) detyron subjektet politike të respektojnë parimet e përfaqësimit gjinor edhe në përbërjen e KZAZ-ve.<sup>1</sup> Shtimi i sanksioneve për shkeljet e neneve dhe rregullave të sipërpërmendura vlerësohet si i domosdoshëm për garantimin e barazisë gjinore.<sup>2</sup>

Në dispozitat e Kodit Zgjedhor (2020) vihet re se akoma ekzistojnë dy standarde ligjore për kuotën gjinore. Në rastin e zgjedhjeve politike parlamentare kjo kuotë është 30% ndërsa në rastin e zgjedhjeve vendore është 50%. Së dyti, barazia gjinore vihet re vetëm në pjesëmarrjen në zgjedhje dhe garën politike, por nuk gjen si konfigurim fundor prezencën reale të përqindjes së grave në organet politike vendimmarrëse, çka nuk garanton përfaqësim real në minimumin ligjor prej 30%.

Zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit 2021, janë të parat zgjedhje parlamentare (zgjedhjet e dhjeta të përgjithshme demokratike në Shqipërinë post-komuniste) që do të kryhen me ndryshime kushtetuese në Kodin Zgjedhor, si rezultat i Reformës Zgjedhore. Risitë në Kodin Zgjedhor, që pritet të jetësohen më 25 prill 2021, janë listat e hapura të kandidatëve për deputetë dhe riformatimi i koalicioneve parazgjedhore. Me riformatimin e koalicioneve parazgjedhore në zgjedhjet parlamentare 2021, forcat politike që bëjnë pjesë në një koalicion do të garojnë me një listë të përbashkët kandidatësh për deputetë, siç është rasti i PD-AN, target i këtij raporti monitorues.

Në sajë të listave të hapura, qytetarët e Shqipërisë do të kenë mundësi të votojnë jo vetëm për forcën politike që preferojnë, por edhe për emrin e kandidatit/es për deputet/e që ata dëshirojnë të jetë anëtar/e i/e parlamentit të ri, gjë që pa ndryshimin përkatës në Kodin Zgjedhor do të ishte e pamundur.

---

<sup>1</sup> <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2020/11/ISP-%E2%80%933-Broshure-informative-mbi-zgjedhjet-ne-Shqiperi-1991-2020.pdf>

<sup>2</sup> UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport 'Standardet e përfaqësimit në partitë politike'. Krasniqi, A.

## KUOTA GJINORE DHE SANKSIONET NGA KQZ

Praktika gjatë zgjedhjeve të vitit 2017 që pasuan ndyshimet në Kodin Zgjedhor (2017) nuk dha rezultatet e pritura. Duke marrë shtysë nga presioni publik i grupeve të interesit dhe ai ndërkombëtar, në vitin 2012, u vendosën penalitete dhe gjopa të ashpra për subjekte politike, të cilat nuk përmbushën kriteret e kuotës gjinore në listat shumë-emërore të kandidatëve. Gjopa varioi nga gjysmë-milion lekë në zgjedhjet lokale deri në 1 milionë lekë në zgjedhjet parlamentare.<sup>3</sup>

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, KQZ vijoi aplikimin e masave penalizuese për partitë politike. Gjatë këtyre votimeve u prekën nga sanksionet për mosrespektim të kuotës gjinore, përpos të tjerave edhe tre partitë kryesore në vend, si PD, PS dhe LSI. Për herë të parë, ndryshe nga partitë e tjera, një forcë politike (LSI) u sanksionua lidhur me mosrespektimin e kuotës gjinore për gjininë mashkullore në listën propocionale për Tiranën. KQZ vendosi sanksione administrative me gjobë në masën 1 milion lekë për Partinë Socialiste, 1 milion lekë për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe në masën 12 milion lekë për Partinë Demokratike<sup>4</sup>.

Në vijim të dorëzimit të listave shumë-emërore nga partitë politike gjatë periudhës parazgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021, KQZ i ktheu 6 subjekteve politike dokumentet e listës së kandidatëve për t'i korrigjuar, mes tyre Koalicionit Zgjedhor "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" (PD-AN) dhe PS (të dyja target të këtij raporti). Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) ishte e vetmja parti që në listat e saj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk konstatoi probleme për numrin e kandidatëve, apo për plotësimin e kuotave gjinore. Pas një procesi ankimesh nga PD-AN lidhur me tejkalimin e numrit të kërkuar të kandidatëve në 11 nga 12 zonat zgjedhore, siç pretendohet nga KQZ, lista shumë-emërore me 222 kandidatë e PD-AN u rrëzua, duke e detyruar PD-AN të kandidojë vetëm 153 kandidatë për deputetë.

## PËRFAQËSIMI I GRAVE NË LISTAT SHUMË-EMËRORE PARTIAKE

Zbatimi i sistemit të kuotave gjinore në zgjedhjet qendrore të vitit 2013 dhe 2017, si dhe në ato vendore në 2015 dhe 2019, ndikoi qartazi pozitivisht në përfaqësimin e grave në strukturat e pushtetit qendror e vendor. Gjithsesi, jo të gjitha qarqet dhe forcat politike patën përmirësimin e dëshiruar në nivelin e përfaqësimit të grave.

<sup>3</sup> UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport 'Standardet e përfaqësimit në partitë politike'. Krasniqi, A., fq. 108.

<sup>4</sup> KQZ (2018). RAPORT Për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2017. Fq 29-30



*Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, me zbatimin e kuotës gjinore në ligj në parlamentin 2009-2013, vetëm 16 për qind e deputeteve ishin gra dhe disa parti iu shmangën hapur kuotave gjinore të imponuara nga ligji. Në ato të vitit 2013, për shkak se Kodi Zgjedhor nuk përcaktonte detyrimin për përfaqësim me kuota gjinore në çdo tre kandidatë, ra dukshëm numri i grave që arritën të renditeshin në listat e partive kryesore në vendet e katërta (vetëm 3 gra), në vendet e pesta (vetëm 5 gra), në vendet e gjashta (vetëm 8 gra) dhe në vendet e shtata (vetëm 5 gra), ndërkohë që sa më në fund të listave shkohej aq më shumë gjendeshin gra candidate. Konkretisht, në vendet e teta ose të nënta në renditje u gjendën përkatësisht 11 dhe 13 gra candidate nga PS, PD e LSI.*


*Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2017, gratë zunë 40.25% të vendeve në listat për candidate për deputetë, ndërsa tre forcat kryesore politike PS, PD-AN dhe LSI (pjesë e analizës së këtij raporti) varionin në përqindje si në vijim: LSI kishte 62 gra candidate (nga 146 kandidatura) kandidatura për deputetë, që përbënin 42,47 % të listës emërore; PS kishte 57 gra candidate (nga 161 kandidatura) në listat emërore në 12 qarqet e vendit, pra 35,40%; dhe PD kishte 39 gra candidate nga 194 kandidatura, pra 20,10% e listës emërore.*

Si pasojë, në zgjedhjet parlamentare 2017 pati ndryshim pozitiv për sa i përket renditjes në listat shumë-emërore, si dhe rritje të numrit të grave deputete. Megjithatë, kjo risi nuk ishte proporcionale në të gjitha partitë politike, por vetëm në disa prej tyre. PS, forca kryesore në vend vendosi 4 gra në krye të listave shumë emërore të qarqeve, ndërsa PD vendosi 2 gra në krye të listave dhe LSI vendosi 3 gra në krye të listave<sup>5</sup>.

Bazuar në listat përfundimtare të miratuara nga KQZ më datë 16.03.2021, të katër forcat politike të marra në analizë në këtë raport, i kanë respektuar dy kriteret bazë që lidhen me përfaqësimin gjinor. Secila forcë politike për çdo zonë elektorale, ka vendosur të paktën 30% gra në listat shumë-emërore për çdo qark, si dhe 1 nga 3 emrat e listës shumë-emërore i përkasin gjinisë femërore.

---

<sup>5</sup> Në Tiranë gratë ishin në 3 vendet e para të listës.



**Grafik 1.** Përqindja e burrave dhe grave kandidate në listat e partive

**Forca kryesore në vend, PS,** me vendim të datës 31 Mars 2021 të KQZ, futet në garë elektorale me 152 kandidatë/e (nga 153 në listën e çertifikuar nga KQZ) në total në listat e saj për çdo qark<sup>6</sup>. 59 gra nga këto 152 kandidatë për deputetë janë gra, pra 39% e listës totale. Gratë kandidate kryesojnë listat e PS në 10 nga 12 qarqet e vendit (83%), duke e bërë këtë rastin e parë në Shqipëri ku gratë kryesojnë listat e një partie në këtë përqindje kaq të lartë. PS ka treguar një rritje eskponenciale të grave në krye të listave nëpër qarqe, nga 4 në zgjedhjet e 2017, në 10 gra në zgjedhjet e 2021. Në disa raste, gratë janë në dy vendet e para të listave në qarqe. Qarqet<sup>7</sup> me përqindjen më të lartë të grave kandidatë të PS janë Gjirokastra (50%), Korça (50%), Lezha (56%), Shkodra (42%) dhe Tirana (39%). Në qarqet e tjera përfaqësimi i grave është 1 në 3 kandidatë.

**Forca tjetër politike PD-AN,** ka në listat e saj përfundimtare shumë-emërore 153 kandidatë/e për deputetë. Gratë përbëjnë 33% të listës shumë-emërore (51 nga 153 kandidime). Ndryshe nga PS, PD-AN nuk ka vendosur asnjë grua në krye të listave shumë-emërore të qarqeve, duke përkeqësuar treguesit e saj gjinorë në këtë këndvështrim, krahasimisht me zgjedhjet e vitit 2017 kur kishte 2 gra në krye të listave të qarqeve. Përsa i përket përqindjes së grave kandidate në listat sipas qarqeve<sup>8</sup>, gratë përbëjnë 33% të listës

<sup>6</sup> Me datë 29 Mars, u nda nga jeta ish-kryeministri Bashkim Fino, i renditur i katërti në listën shumë-emërore të PS-së në Qarkun e Fierit. Me vendim të datës 31 mars 2021, [http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim\\_nr\\_198\\_210401\\_Per-miratimin-e-permbajtjes-se-fletes-se-votimit.pdf](http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Vendim_nr_198_210401_Per-miratimin-e-permbajtjes-se-fletes-se-votimit.pdf)

KQZ ka hequr emrin e Bashkim Finos nga fleta e votimit për qarkun e Fierit. Duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk lejon ndryshime të kandidatëve pas regjistrimit, kryekomisioneri ka hartuar fletë votimi ku vendi i 4-t që i përkiste kandidatit për deputet Bashkim Fino është bosh. Ndërkohë, në listë, kandidatët vijues të PS ruajnë të njëjtat pozicione si më parë. Vendi i 4-t është bosh dhe votuesit nuk i ofrohet asnjë emër/numër për t'u zgjedhur. Nëse një votues/e vendos kryq në hapësirën bosh, vota nuk llogaritet për askënd.


<sup>7</sup> Berat 3/9; Dibër 2/6; Durrës 5/15; Elbasan 5/15; Fier 6/18; Gjirokastrë 3/6; Korçë 6/12; Kukës 1/3; Lezhë 5/9; Shkodër 5/12; Tiranë 14/36; Vlorë 4/12.

<sup>8</sup> Tiranë 12/26; Fier 6/18; Durrës 5/15; Elbasan 5/15; Korçë 4/12; Shkodër 4/12; Vlorë 6/18; Berat 3/9; Lezhë 3/9; Dibër 2/6; Gjirokastrë 2/6; Kukës /3

në çdo qark, 1 në 3 kandidatë. Në shumicën dërrmuese gratë renditen të tretat në çdo treshe kandidatësh në lista.

**LSI në listën e saj shumë-emërore** prej 153 kandidaturash për deputetë, ka përfshirë 60 gra, të cilat përbëjnë 39% të kësaj liste. Gratë kryesojnë listat emërore në 4 qarqe<sup>9</sup>, por në 3 nga këto qarqe<sup>10</sup> emri që kryeson listën është i njëjti, ai i kryetares së kësaj forcë politike. Gratë përfaqësohen<sup>11</sup> në përqindje më të larta se pragu ligjor (1 në 3 kandidatë) në qarqet Shkodër (58%), Dibër (50%), Lezhë (45%), Elbasan (40%), Tiranë dhe Fier (39%).

**Forca e re politike 'Nisma Thurje'**, në listën e saj shumë-emërore prej 153 kandidaturash për deputetë/e ka përfshirë 68 gra kandidate, që përbëjnë 45% të listës shumë-emërore në 12 qarqe. Gratë kryesojnë listën në 4<sup>12</sup> nga 12 qarqe të vendit të kësaj force politike. Përqindja më e lartë e përfaqësimit të grave në lista është si më poshtë:<sup>13</sup> Berat (67%), Elbasan (60%), Vlorë (50%), Lezhë (66%), Durrës (47%), Korçë (42%) dhe Fier (39%).



**Grafik 2.** Përqindja e burrave dhe grave kandidate në krye të listave shumë-emërore

**Kandidime rishtazi/të reja:** Lidhur me numrin e grave që kandidojnë rishtazi dhe atyre që kandidojnë për herë të parë në listat shumë-emërore të katër forcave politike, më poshtë gjeni një grafik të ndarë në përqindje për këto dy kategori për secilën parti, krahasuar me listat shumë-emërore të kandidatëve/eve gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017. PS është partia që ka më shumë kandidatura të reja në listat e saj (18 kandidatura të reja nga 59 gra kandidate), e ndjekur nga PD (13 nga 51 gra kandidate) dhe LSI (10 nga 60 gra kandidate).


<sup>9</sup> Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë

<sup>10</sup> Elbasan, Fier, Tiranë

<sup>11</sup> Vlorë 4/12; Tiranë 14/36; Shkodër 7/12; Lezhë 4/9; Kukës 1/3; Korçë 4/12; Gjirokastër 2/6; Fier 7/18; Elbasan 6/15; Durrës 5/15; Dibër 3/6; Berat 3/9.


<sup>12</sup> Berat, Durrës, Elbasan, Lezhë

<sup>13</sup> Vlorë 6/12; Tiranë 312/36; Shkodër 4/12; Lezhë 6/9; Kukës 1/3; Korçë 5/12; Gjirokastër 2/6; Fier 7/18; Elbasan 9/15; Durrës 7/15; Dibër 2/6; Berat 6/9.



**Grafik 3.** Përqindja e grave kandidate që kandidojnë rishtazi, si dhe për herë të parë në zgjedhjet parlamentare 2021


**Mosha e grave kandidate:** Nëse e shohim përfshirjen e grave në politike edhe në këndvështrimin e moshës së kandidateve në listat shumë-emërore, do të vëmë re që ka diferenca të mëdha nga njëra forcë politike tek tjetra. Ajo që bie në sy është që partia e sapokrijuar 'Nisma' ka një mesatare moshore ndjeshëm më të re krahasimisht me partitë e tjera më të mëdha e më të vjetra. Mosha mesatare e grave kandidate të partisë Nisma është 29 vjeçe, ndjekur nga LSI që ka moshën mesatare 37.3 vjeçe, më pas nga PS me mesatare 41.7 vjeçe dhe në fund nga PD-AN me mesatare 43.3 vjeçe. Nisma Thurje ka 16 gra kandidate në grupmoshën 20-24 vjeç përgjatë listave të saj shumë-emërore, ndërsa LSI ka 6 kandidate në këtë grupmoshë dhe 1 kandidate 19 vjeçare që është edhe kandidatja më e re në mesin e grave kandidate të katër forcave politike të marra në analizë. Kandidatet më të reja të PS (3) janë të grupmoshës 23-24 vjeçare dhe kandidatja më e re e PD-AN është 22 vjeçare (vetëm 1 në fashën 19-24 vjeç) . Kandidatja më e madhe në moshë është 79 vjeçare dhe kryeson listën e PS në Tiranë.



**Grafik 4.** Moshë mesatare e grave kandidate në listat shumë-emërore të PS, PD-AN, LSI dhe Nisma gjatë zgjedhjeve parlamentare 2021

## PËRFAQËSIMI I GRAVE NË PËRBËRJEN E KZAZ<sup>14</sup>

Në 3 proceset e fundit zgjedhore (që nga 2013), përfaqësimi i grave në përbërjen e KZAZ-ve shënon tendencë shumë të lehtë rritjeje sidomos gjatë 2017 dhe 2021, duke qenë thjesht në pragun ligjor të kuotës gjinore prej 30%.



**Grafik 5.** Përqindja e burrave dhe grave në përbërjen e KZAZ-ve në proceset zgjedhore të viteve 2013, 2017 dhe 2021

<sup>14</sup> KQZ (2018) RAPORT Për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2017, fq 18-19.

Në zgjedhjet parlamentare të 2017, **PS** propozoi 270 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 97 ose 35.9 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Në përfundim të procesit zgjedhor, 100 ose 37 % e anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga PS ishin gra, nga të cilat: 11 ushtruan detyrën e Kryetares së KZAZ-së; 10 ushtruan detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së; 16 ushtruan detyrën e Sekretares së KZAZ-së dhe 63 ushtruan detyrën e anëtares së KZAZ-së.

**PD** propozoi 270 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 90 ose 33.3 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Në përfundim të procesit zgjedhor, 94 ose 34.8 % e anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga PD ishin gra, nga të cilat: 12 ushtruan detyrën e Kryetares së KZAZ-së; 8 ushtruan detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së; 8 gra ushtruan detyrën e Sekretares së KZAZ-së dhe 66 gra ushtruan detyrën e anëtares së KZAZ-së.

**Lëvizja Socialiste per Integrim** propozoi 90 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 11 ose 12.2 % prej tyre ishin gra.


Zëvendësimet e kërkuara nga PS dhe PD nuk cënuan respektimin e kuotës gjinore. LSI kërkoi lirin e 4 grave anëtare të KZAZ dhe emëroi 1 grua. Respektimi i kuotës gjinore sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor edhe për këtë proces zgjedhor dëshmoi se nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ. Në 57 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën kuotën 30%.

**Bazuar në të dhënat nga KQZ (2021)** lidhur me zgjedhjet parlamentare të 2021, **PS** propozoi 392 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, nga ku 146 ose 37 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Sipas listës së emërimeve, 7 gra ushtrojnë detyrën e Kryetares së KZAZ-së, përkundrejt 39 burrave; 14 janë emëruar në detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së, përkundrejt 30 burrave; 1 grua është emëruar në detyrën e Sekretares së KZAZ-së, përkundrejt 23 burrave; 124 gra ushtrojnë detyrën e anëtares së KZAZ-së.

**PD** propozoi 272 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, 77 ose 28 % prej tyre ishin gra. Pas lirim/emërimeve të kërkuara të kërkuara nga kjo parti, kuota gjinore nuk u cënua. Sipas listës së emërimeve, 7 gra ushtrojnë detyrën e Kryetares së KZAZ-së, përkundrejt 39 burrave; 17 janë emëruar në detyrën e Zv/Kryetares së KZAZ-së, përkundrejt 30 burrave; asnjë grua nuk është emëruar në detyrën e Sekretares së KZAZ-së, përkundrejt 39 burrave; 53 gra ushtrojnë detyrën e anëtares së KZAZ-së.

**Lëvizja Socialiste për Integrim** propozoi 89 anëtarë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, por 3 (burra) prej tyre nuk u pranuan nga KQZ. 10 ose 11.2 % prej tyre ishin gra.


Zëvendësimet e kërkuara nga PS, PD dhe LSI nuk çënuan kuotën gjinore fillestare, pasi anëtarët u zëvendësuan më të tjerë të të njëjtës gjini. Respektimi i kuotës gjinore sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, ashtu si në zgjedhjet e 2017, dëshmoi se nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ. Në 47 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën kuotën 30% ndërkohë që në zgjedhjet e 2017, në 57 KZAZ përfaqësimi i grave ishte nën 30%.



**Grafik 6.** Numri i burrave dhe grave të PD, PS, dhe LSI në 92 KZAZ-të e vendit

Vërehet se gratë përbëjnë 31% (231 gra nga 736) të numrit total të emërimeve në 92 KZAZ-të e vendit. PS ruan të njëjtin trend në përqindje lidhur me përfaqësimin e grave në KZAZ (37%) në zgjedhjet e 2017 dhe 2021, PD ka një ulje domethënëse nga 34,8% (2017) në 28% (2021) duke rënë nën kufirin 30% të kuotës gjinore. LSI gjithashtu rezulton të ketë një ulje të lehtë nga 2017 në 2021, duke mbetur shumë poshtë kufirit ligjor.


Të dyja, PS dhe PD kanë ulur numrin e grave të emëruar Kryetare të KZAZ-ve, ndërkohë që kanë rritur ndjeshëm numrin e emërimeve për Zv/Kryetare. Sekretaret e KZAZ-ëve janë gati inekzistente (1 në total) krahasimisht me 62 sekretarët e emëruar nga PS dhe PD.



**Grafik 7.** Ndarja gjinore sipas emërimeve për PS dhe PD në 92 KZAZ-të e vendit

## PËRFAQËSIMI GJINOR NË PARLAMENTIN SHQIPTAR

Kurba e përfaqësimit gjinor ka ndryshuar pozitivisht në zgjedhjet parlamentare. Më 1991 gratë deputete zinin vetëm 4% të vendeve në parlament, më 1992, 2001 dhe 2005 gjithashtu ato patën raporte minimale përfaqësimi (6-7%), por pas vitit 2019 dhe aplikimit të sistemit proporcional me lista të mbyllura përqindja u rrit ndjeshëm. Në zgjedhjet e vitit 2009 gratë deputete zinin 16%, më 2013 arritën në 29% dhe më 2017 në 26%.<sup>15</sup>



**Grafik 8.** Përfaqësimi grave deputete në parlament 1991-2017.

Burimi: ISP (2020), Broshurë-informative-mbi-zgjedhjet-ne-Shqiperi-1991-2020

<sup>15</sup> <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2020/11/ISP-%E2%80%93-Broshure-informative-mbi-zgjedhjet-ne-Shqiperi-1991-2020.pdf>



Gjatë legjislaturës 2013-2017, rritja e numrit të grave deputete erdhi më shumë si pasojë e detyrimit në Kodin Zgjedhor për zëvendësimin e mandateve me gjininë më pak të përfaqësuar sesa përmes fitores së drejtpërdrejtë të mandateve. Konkretisht, nga 36 mandate parlamentare të ndryshuara gjatë kësaj legjislature, 17 mandate i kaluan grave deputete të listës, shifër shumë më e lartë sesa numri i grave që u zgjodhën direkt nga mandatet e fituara në shtator 2013.

Konkretisht, në Kuvendin e Shqipërisë, më 2016, pas ndryshimeve të reja që ndodhën në listën e deputetëve pas kandidimit të disa prej tyre në zgjedhjet lokale, numri i grave/vajzave deputete arriti në shifrën 33, shifër rekord për të gjitha vitet e mëparshme të tranzicionit në Shqipëri. Në totalin e 140 deputetëve, gratë zinin 23% nga 18% që u regjistruan menjëherë pas zgjedhjeve 2013.

Më 2017 për herë të parë në historinë e tranzicionit demokratik në Shqipëri, gratë dhe vajzat kanë 28% të vendeve në parlament. Partitë kryesore përfaqësoheshin në nivel përqindjeje<sup>16</sup> me 29.73% (PS), 25,58% (PD), 26,32 (LSI) gra deputete në parlament. Janë zgjedhur 39<sup>17</sup> gra deputete, 22 prej të cilave për herë të parë si përfaqësuese në parlament. Ky përfaqësim është një arritje e rëndësishme e grupeve lobuese politike e civile për kuotë përfaqësimi 30% në parlament dhe një referencë frymëzuese për qëndrueshmërinë dhe rritjen e përfaqësimit të barabartë të grave në të gjitha sferat e politikës vendimmarrëse.<sup>18</sup>

Referuar raporteve gjinore (janar – korrik 2017) rezulton se *qarku* me përqindjen më të lartë të përfaqësimit gjinor (deputete gra / vajza) është Shkodra me 36,63%, ndjekur nga Elbasani e Lezha me nga 28,57%, si dhe Berat, Korçë, Kukës e Vlorë me nga 25%. Durrësi kishte kuotë përfaqësimi prej 23% pasuar nga Tirana me 21,87% dhe Dibra me 16,66%. Qarku i vetëm pa asnjë deputete në parlament ishte Gjirokastra me 5 deputetë burra.

Në qeverinë e re të dalë nga zgjedhjet parlamentare 2017, PS zgjodhi një grua në postin e zv/ kryeministrit. Për herë të parë në historinë e Shqipërisë kemi numrin më të lartë të grave ministre, shifër që arriti në 9 nga 16 ministra/e në qeverinë në fuqi (2021).

## **PËRFAQËSIMI I GRAVE NË ORGANET VENDIMMARRËSE PARTIAKE**

Një element i rëndësishëm i vlerësimit të pozitës së grave në vendimmarrjen politike të partive lidhet me vendin që ato zënë në këto struktura. Me gjithë trendin pozitiv dhe premtimet e partive, përfaqësimi i grave në organet vendimmarrëse partiake është ende në nivel të ulët. Pengesat kryesore për këtë përfaqësim lidhen me faktorë të ndryshëm, ku më kryesorja është kultura patriarkale mbizotëruese në shoqëri dhe rrjedhimisht në klasën

<sup>16</sup> KQZ (2018) RAPORT Për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2017. Fq 29

<sup>17</sup> 22 nga PS, 11 nga PD, 5 nga LSI, si dhe 1 deputete grua e Partisë 'Drejtësi, Integrim dhe Unitet'

<sup>18</sup> UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport 'Standardet e përfaqësimit në partitë politike'. Krasniqi., A.

politike në vend. Megjithatë, trendi në rritje i përfaqësimit të grave në vendimmarrje politike tregon se përpjekjet shumë-anëshe në nivel politikash dhe nismash të shoqërisë civile në këtë drejtim, po sjellin rezultate gjithnjë e më inkurajuese dhe të qëndrueshme.

Partitë politike parlamentare, sidomos tri partitë e mëdha, PS, PD e LSI kanë sanksionuar në statutet dhe dokumentet e tyre të brendshme praktika pozitive të kuotave dhe angazhime për promovimin e grave në politikë. Kuotat gjinore janë përfshirë dhe përcaktuar si pjesë e strukturave të dy partive kryesore politike (PS e PD) që prej mesit të viteve '90. Niveli i përfaqësimit të barabartë gjinor ka pasur trend rritës<sup>19</sup>.

**Kryesimi i partive:** Referuar të dhënave krahasimore në 3 partitë parlamentare si target i këtij raporti, rezulton se asnjëra nga dy partitë e mëdha (PS dhe PD) nuk ka pasur dhe as ka grua kryetare ose kandidatë potenciale për kryetare partie. LSI, me anë të zgjedhjeve partiake në zgjedhjet e fundit zgjodhi një grua kryetare më 2017, kryetare që vazhdon të mbajë këtë post edhe gjatë zgjedhjeve parlamentare 2021. Edhe partia e re 'Nisma' që garon në zgjedhjet parlamentare të 2021, ka për kryetar një burrë. *Lidhur me strukturat drejtuese*, parti të ndryshme aplikojnë modele të ndryshme organizimi, duke pasur kështu sekretariat aktiv (PS) ose nënkryetarë (PD).

**Partia Socialiste:** Në zgjedhjet për delegatët e kongresit të PS (16.11.2019) sipas parimit një anëtar, një votë, 47% e kandidatëve për delegatë të Kongresit të PS ishin gra. Sipas PS, në strukturat e partisë, gratë përbëjnë 45.2% të Asamblesë Kombëtare. Pas zgjedhjeve brenda partisë në vitin 2020, PS ka në sekretariatit e saj 3 gra nga 10 anëtarë (30%) të këtij sekretariati, dukë shënuar një rritje krahasimisht me periudhën paraardhëse ku gratë zinin 25% të vendeve në sekretariatit e PS-së. Kryesia e PS-së përbëhet nga 36% gra, pra 22 anëtarë/e, 8 prej të cilëve janë gra,<sup>20</sup> duke ruajtur afërsisht të njëjtin trend të katërvjeçarit paraardhës ku gratë përbënin 33% të Kryesisë së PS-së. Forumi rinor i PS (FRESSH) drejtohet nga një burrë.

Aktualisht, gratë drejtojnë vetëm 8 nga 61 degët e PS, ndërkohë që në periudhën paraardhëse drejtonin 12 nga 61 degët në vend. Kufiri ligjor gjinor nuk respektohet nga kjo forcë politike lidhur me këtë komponent. Një përfaqësim i dobët gjinor vihet re edhe në nivel drejtuesish politikë të fushatës zgjedhore, ku vetëm 3 nga 14 drejtuesit politikë janë gra.

**Partia Demokratike:** Kryesia e PD vijon të dominohet nga burrat dhe ka aktualisht dy nënkryetarë burra, si dhe një burrë sekretar të përgjithshëm. Kryesia e PD ka treguesin më të dobët gjinor krahasimisht me PS dhe LSI, pasi vijon të përbëhet nga 23% gra, pra nga 30 anëtarë/e, 7 janë gra 9. Edhe forumi rinor i kësaj partie (FRD) drejtohet nga një burrë. Në Asamblenë e PD-së, 19% e anëtarëve janë gra.

---

<sup>19</sup> Informacion më i detajuar gjendet në kapitulin që vijon.

<sup>20</sup> Bazuar në informacionet e publikuara në [www.ps.al](http://www.ps.al)

Në PD nga 61 degët e partisë në rrethe, pas zgjedhjeve partiake në Dhjetor 2018, ka vetëm një grua kryetare.<sup>21</sup> Ndërkohë, numri i drejtueseve politike të fushatës zgjedhore 2021 është vetëm 3 nga 16 në total.

**Lëvizja Socialiste për Integrim:** Edhe pas zgjedhjeve brenda partisë në nëtor 2020, LSI vijon të drejtohet nga një grua, ndërkohë që ka burra në pozicionet e zv.kryetarit dhe sekretarit të përgjithshëm. Nga tre nënkryetarët e partisë, 1 është grua. Lëvizja rinore (LRI) e LSI ka kryetare një grua, ndryshe nga dy partitë e tjera të mëdha. Kryesia e LSI është ajo që ka balancën më të pëlqyeshme gjinore brenda kryesisë së saj, krahasimisht me partitë e tjera të mëdha në vend, me një përqindje afro 50% gra në kryesi (12 nga 25 anëtarë), duke shënuar rritje me 4 vjeçarin e mëparshëm ku gratë politike zinin 35% të vendeve në Kryesinë e LSI-së. Në asamblenë e LSI, 33% e vendeve zihet nga gratë.

Në LSI<sup>22</sup>, deri në zgjedhjet e fundit partiake nuk kishte asnjë grua kryetare në 61 kryetarët e degëve lokale të secilës parti, ndërkohë që aktualisht<sup>23</sup> nuk ka asnjë informacion zyrtar rreth kryetarëve/eve të degëve. Nga 12 drejtuesit politikë të fushatës zgjedhore, vetëm 3 janë gra, një prej tyre vetë kryetarja e kësaj force politike.

**Partia 'Nisma Thurje':** Nisma është një nga forcat e reja politike në vend që regjistrohet për herë të parë si garuese në zgjedhje parlamentare. Kjo parti ka kandiduar 12 deputetë në krye të listave të saj, 3 prej tyre janë gra. Në statutin e kësaj partie kongresi është organi më i lartë vendimmarrës i organizatës. Kongresi i organizatës përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga nyjet e organizatës, si dhe nga funksionarë të organizatës ex-officio. Çdo njeje e regjistruar, zgjedh përfaqësuesin e vet në Kongres, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të regjistruar në nyjen përkatëse. Lidhur me përfaqësimin gjinor në strukturat drejtuese të partisë (kongresi, çentrali, sekretariati), 59% e 153 anëtarëve të kongresit janë gra, çentrali me 6 anëtarë ka vetëm 1 anëtare grua dhe sekretari i përgjithshëm është burrë. Sekretariati i partisë është në ndërtim e sipër dhe pritet të ketë 50% gra në përbërje<sup>24</sup>. Në nyjet lokale 33% e drejtuesve/eve janë gra dhe 40% në nyjet e diasporës.

Forcat politike kanë shënuar hapa pozitivë drejt barazisë gjinore në strukturat vendimmarrëse të tyre. Statutet e tyre sanksionojnë kuota gjinore, ndërkohë që vihet re interes politik dhe elektoral për rritjen e përfaqësimit të grave brenda partisë. Tri partitë kryesore politike në vend, target i këtij raporti, kanë përqindjen më të lartë të përfaqësimit cilësor të grave e vajzave, duke bërë diferencë të madhe me partitë e tjera më të vogla parlamentare.

Gjithsesi, qartazi drejtimi i partive politike në Shqipëri vijon të konsiderohet monopol i politikanëve burra. Akoma ka nevojë për përpjekje për të pasur në vend mekanizma që

<sup>21</sup> Mirlinda Collaku, Dega nr.2 Tiranë

<sup>22</sup> UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport 'Standardet e përfaqësimit në partitë politike'. Krasniqi, A., fq. 46.

<sup>23</sup> Prill 2021

<sup>24</sup> Sipas komunikimit me sekretarin e përgjithshëm.

rrisin besimin, mbështetjen dhe konkurrencën transparente në mënyrë që sa më shumë gra të mund të përfshihen në politikëbërje dhe të zgjidhen në role vendimmarrëse. Është shqetësuese sidomos përqindja shumë e ulët e grave në drejtimin e degëve lokale të partive, të cilat dukshëm vazhdojnë të konsiderohen si terren i burrave.

## QASJA GJINORE NË DOKUMENTET STATUTORË TË PARTIVE<sup>25</sup>

Siç e kërkon ligji, çdo parti politike vepron si institucion më vete, me të gjithë dokumentacionin dhe strukturën e saj të pavarur. *Statutet e partive* janë një dokument shumë i rëndësishëm rregullator i partive, lidhur me organizimin dhe mirëfunksionimin e tyre, konform parimeve kushtetuese dhe ligjore. Një studim i ISP (2018), përmbledh një analizë të përmbajtjes së statuteve të partive politike që kanë qenë prezent në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2017me qëllim analizimin e shkallës së tyre të përafrimit ligjor lidhur me barazinë gjinore. Për arsye të fokusit të këtij raporti, po përmendim disa gjetje të studimit të ISP lidhur me 3 partitë parlamentare që janë në analizën tonë.

**PS** në Nenin 3 të statutit garanton shanse të barabarta në përfaqësimin midis grave dhe burrave. Në nenin 23 ajo sanksionon se çdo organizatë e partisë mbështetet në parimin e jo më pak se 30% të përfaqësimit gjinor të grave në jetën politike të saj. Në nenin 37 të statutit ku parashikohen rregullat e përzgjedhjes së delegatëve në kongres vendoset rregulli se lista e kandidatëve për t'u votuar dhe lista e fituesve si delegate duhet të sigurojnë një përfaqësim të barabartë prej 50% për të dyja gjinitë. Kriteri i barabartë prej 50% vendoset edhe për kandidaturat që do të zgjidhen nga kongresi i partisë për anëtarë të Asamblesë Kombëtare të PS. Sipas Nenit 43 përfaqësia gjinore femërore për të garuar për në kryesinë e PS duhet të jetë në një kuotë më të vogël e përbërë nga 30% të tyre. Ndërkohë që, sipas nenit 63 të Statutit, lista e kandidatëve që garojnë për Këshillat Vendore duhet të respektoj barazi të plotë gjinore prej 50%. Kjo parti ka të krijuar me statut edhe Forumin e Gruas Socialiste, i cili në zgjedhjet e dhjetorit 2016 deklaroi një anëtarësi prej 30 mijë grash dhe vajzash. Statuti nuk jep rregulla për kandidimin në zgjedhje me kuota gjinore dhe për rotacione gjinore në strukturat drejtuese monokratike të partisë.

**PD** në statutin e saj në nenin 22 të tij parashikon që në kryesinë e degës duhet të ketë gjini femërore të votuar dhe pjesëmarrëse në këtë forum jo më pak se 30% të numrit të përgjithshëm. Po ashtu edhe në nenin 36 të këtij statuti ku flitet për anëtarësinë e zgjedhur në Këshillin Kombëtar të kësaj partie vendoset sërish kuota jo më pak se 30% të përfaqësimit femërore në këtë strukturë të lartë partiake.

Edhe në rastin e PD-së, nuk jepen rregulla për kandidimin në zgjedhje me kuota gjinore dhe për rotacione gjinore në strukturat drejtuese monokratike të partisë. Statuti i PD ka

<sup>25</sup> UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport 'Standardet e përfaqësimit në partitë politike'. Krasniqi., A.

respektuar kuotën minimale të vendosur nga ligji për barazinë gjinore. Kjo parti parashikon në statutin e saj një organizatë partnere brenda subjektit të saj politik e cila përfaqëson gjininë femërore të quajtur Forumi i Gruas Demokratë. Neni 21, pika J përcakton se Kuvendi i Degëve të partisë përfshin deri në 5% përfaqësues të zgjedhur LDG.

**LSI** në statutin e saj dhe konkretisht në kreun 17 pika 3 parashikon se Lëvizja e Gruas për Integrim përfaqësohet me lista të veçanta kandidimi për në forumet e LSI-së në të gjitha nivelet në masën jo më pak se 50%. Parimi i barazisë gjinore është i detyruar të respektohet në përbërjen e të gjitha forumeve të LSI-së. Kjo është dispozita e vetme që përmban Statuti i LSI-së por në mënyrë imperative konfirmon vullnetin e kësaj partie për të pasur përfaqësi të barabartë në çdo forum politik brenda saj. Kjo parti ka krijuar me status edhe forumin e gruas, të quajtur Lëvizja e Gruas për Integrim.

**Nisma Thurje** në statutin e saj nuk ka asnjë nen që prek çështjen e kuotave gjinore apo të përfaqësimit të grave në strukturat e saj partiake. Parimi i barazisë gjinore respektohet në gjuhën e balancuar përdorur në statut (ai/ajo; tij/saj). Kjo parti ka përmendur në status edhe forumin 'Thurje Barazia', si një nga tre entet e pavarura të saj, por ky entitet nuk ka vënë theks të veçantë tek barazia gjinore, pasi do të mbulojë çështje që lidhen me të gjitha format e pabarazive në përgjithësi.

## PROBLEMATIKA KRYESORE E REKOMANDIME LIDHUR ME PËRFAQËSIMIN GJINOR

- Kuota gjinore që synon përfaqësimin e barabartë mes gjinive tashmë është një kusht që respektohet nga forcat politike në tërësinë e listave shumë-emërore të partive. Vendosja e grave në lista dhe zona me mundësi më të lartë për fitimin e mandatit është shumë e rëndësishme, përpos zbatimit faktik të kuotës gjinore në tërësi. Në zgjedhjet 2017 partia që kryeson me përfaqësimin më të lartë të grave në parlament është PS me 27% ndjekur nga PD me 25% dhe LSI me 21%. Ndyshimet në Kodin Zgjedhor kanë bërë të mundur që të evitohen tentativat për të mos përfshirë mjaftueshëm gra (minimalisht 1 në 3) në listat për kandidatë për deputetë. Gjithsesi, respektimi i kuotës 30% nuk arrin akoma të garantojë përfaqësimin e grave në parlament në minimumin e kuotës, pasi më së shumti gratë janë vendosur të fundit në çdo tresheje të njëpasnjëshme nëpër listat shumë-emërore. Gjithsesi, shtimi i grave (10 gra kryesojnë 12 listat e qarqeve) që kryesojnë listat shumë-emërore nga forca kryesore në vend, PS, është një tregues mjaft pozitiv, megjithëse forcat e tjera politike nuk njohin trende pozitive rritjeje në këtë aspekt.

Për të arritur një përfaqësim të barabartë gjinor, qoftë edhe në minimumin 30%, nevojitet vullnet i shtuar nga forcat politike për të renditur gratë në pozita fituese njëjloj si burrat.

- Qartazi drejtimi i partive politike në Shqipëri vijon të jetë terren i mbizotëruar gati tërësisht nga politikanë burra. Akoma ka nevojë për përpjekje në mënyrë që sa më shumë gra të mund të përfshihen në politikëbërje dhe të zgjidhen në role vendimmarrëse. Është shqetësuese sidomos për qindja shumë e ulët e grave në drejtimin e degëve lokale të partive, si dhe në drejtimin politik të fushatës zgjedhore në terren, detyrë që vetëm rrallëherë u besohet grave.  
Partitë duhet të mbajnë parasysh që drejtimi i degëve lokale të partive duhet të reflektojë njëjloj si në çdo strukturë tjetër partiake parimin e kuotave gjinore dhe të sigurojnë një përfaqësim minimal prej 30% të grave në nivele drejtuese lokale.
- Duke ndjekur trendin pozitiv të vitit 2017, në zgjedhjet parlamentare të 2021, po vërehet që partitë po tregohen më të hapura dhe më të gatshme të promovojnë gratë kandidate. Në disa raste, pjesëmarrja e shtuar e grave po përdoret nga partitë kryesore si një strategji zgjedhore për të tërhequr vëmendjen e elektoratit të grave.  
Rekomandohet që angazhimi politik i grave të marrë vëmendjen e duhur gjatë gjithë aktivitetit politik të forcave politike në vend dhe të mos përbëjë një çështje prioritare vetëm gjatë proceseve zgjedhore.
- Në 3 proceset e fundit parlamentare përfaqësimi i grave në përbërjen e KZAZ-ve në total shënon tendencë shumë të lehtë rritjeje, thjesht duke ruajtur pragun ligjor të kuotës gjinore prej 30%. Respektimi i kuotës gjinore sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, vazhdon të dëshmojë se nuk realizon përfaqësimin 30% të grave në çdo KZAZ, pavarësisht përmirësimit shumë të lehtë që ka pësuar ky tregues.  
Rekomandohet që të tregohet vëmendje e shtuar ndaj angazhimit të grave në KZAZ, duke u besuar atyre më shpesh role drejtuese brenda këtyre strukturave vendore.

## Referenca

### Dokumente ligjore:

LIGJ Nr. 10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012 , nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020)

LIGJ Nr. 8580, datë 17.2.2000 PËR PARTITË POLITIKE (ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017, nr. 135/2020, datë 16.11.2020; shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001) (i përditësuar, 2017)

Statutet partiake të PS, PD, LSI dhe Nisma

### Informacione nga kontakti direkt me strukturat drejtuese të partive

### Raporte:

UN Women Shqipëri dhe Instituti i Studimeve Politike (2017). Raport ‘Standardet e përfaqësimit në partitë politike’. Krasniqi., A.

KQZ (2018) RAPORT Për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 Janar – 31 Dhjetor Viti 2017.

### Linqe:

[www.ps.al](http://www.ps.al)

[www.pd.al](http://www.pd.al)

[www.lsi.al](http://www.lsi.al)

[www.nismathurje.al](http://www.nismathurje.al)

<http://kqz.gov.al/>